



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

Ministria e Diasporës, në pajtim me nenin 6, parag. 3, dhe nenin 7 të Rregullores nr.01/2012 për kriteret dhe mënyrën e dhënies së Çmimit Vjetor të Diasporës dhe Mërgatës për grupin ose mërgimtarin më të suksesshëm të vitit, shpall:

K O N K U R S

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS PËRFUNDIMTARE TË CERTIFIKATËS DHE TË DIZAJNIT TË SIMBOLIT PËR ÇMIMIN VJETOR TË DIASPORËS DHE MËRGATËS PËR GRUPIN OSE MËRGIMTARIN MË TË SUKSESSHËM TË VITIT

Kushtet e përgjithshme:

- Certifikata dhe simboli duhet të kenë elemente artistike që reflektojnë vlerat më të larta të diasporës dhe mërgatës së Republikës së Kosovës.
- Çmimi jepet për grupin ose mërgimtarin më të suksesshëm të vitit, i cili ka dhënë kontribut të veçantë në këto fusha:
 - veprimtari humanitare,
 - kontribut të veçantë për shtetin e Kosovës ose për diasporën dhe mërgatën,
 - arsim, shkencë ose teknologji
 - kulturë ose sport, dhe
 - biznes.
- Për kontribut të veçantë jetësor në fushat nga paragrafi 1 i këtij neni jepet çmimi *post-mortem*.
- Pjesëmarrësit mund të konkurrojnë vetëm me një zgjidhje ideore.
- Zgjidhja ideore duhet të jetë e punuar enkas për këtë konkurs, nuk duhet të jetë e paraqitur në ndonjë konkurs të mëparshëm ose e realizuar dhe e përdorur për ndonjë organizatë a ngjarje tjetër.

- Dokumentacioni përcjellës duhet të jetë me shifër, jo me emër e mbiemër të pjesëmarrësit.
- Bashkë me propozimin, pjesëmarrësi duhet t'i dërgojë edhe tri fotografi me ngjyra të simbolit të propozuar (ballore, profili dhe prapa), me përmasa jo më të vogla se formati A4 (29X21cm).
- Shpërblimi për fituesin është 1 000 €.
- Konkursi është i hapur prej sot, më 7.6.2013, deri më 23.6.2013.
- Dorëzimi dhe regjistrimi i propozimeve bëhet në arkivin e MeD-së. Për çdo informacion mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 038 200 17 029.
- Pas datës 23.6.2013, asnjë propozim nuk do të pranohet për konkurrim.
- Propozimet e refuzuara të pjesëmarrësve duhet të tërhiqen më së voni 15 ditë pas shpalljes së fituesit. Për mostërheqjen e tyre me kohë, MeD nuk mban përgjegjësi.
- Në rast se propozimet nuk do të tërhiqen brenda afatit të caktuar, MeD do ta bëjë asgjësimin e tyre.
- Me përfundimin e konkursit dhe pas shpalljes së propozimit fitues, ndërmjet pjesëmarrësit dhe MeD-së lidhet një marrëveshje për pagesën dhe kushtet e tjera në përgjithësi.

Konkursi është i hapur për të gjithë të interesuarit që vlerësojnë se mund të japin propozime.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Ministrinë e Diasporës (ndërtesa e ish-Gërmisë), në zyrën BD-25, ose nëpërmjet adresës elektronike: ministriaediasopres@rks-gov.net